

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1
N 20

NEXHAT HAKIU

Këndoja...

TIRANË, 1958

8JH-1

1420

NEXHAT HAKIU

Pa tashmë koh Partipi
në qeverinë e lirëtar,
tur mësim vëgjillja
nëtë ngrënës gjekur.

KENDOJ...



Redaktori: Mito Radoševci

NDERMARRJA SHTETËRORE E BOTIMEVE

TIRANË, 1958

Spellym është shtetërore ministr i Ministrat Durrës — Tirana

... Po lavdija ish Partija
në kushtrimin çlirimtar,
kur sulmoi vegjelija
mbi fashizmin gjakatar.

O I HUAJATE

E pse vjen.
pse gënjen,
or i huaj?

Tokën time as ta lë, as ta huaj!

Ja, ti erdhe,
po ta dish se nuk më zverdhen
as me hekur
as me arë —
veç u skuqa nga të vdekur,
që me gjak e kanë larë
dhe me djers'e e kan' vaditur
tokën, që ti ke grabitur!

Po, do shkosh,
do çfarosh,
or i huaj!
Tokën time as ta lë, as ta huaj!

Ti s'beson
dhe kujton
se me plumba më frikson,
po s'kam frikë,
di që s'kam as çelnik
të të shporr ty armik,
pra me gur,
me pështymë

— si dikur —
në flak' e tym,
si kudo edhe në Vlorë,
do të bjenë prap' dëshmorë,
që në gojë plumbin tretin,
se krahrorin kanë hekur,
brenda mbajnë: amanetin
nga të vdekur!

«TETARI I ROJËS!»

— Ndal!

«Tetar i Rojës!»

Ndal! —

Mbeti shtang i mjeri djalë!
Po me bisht të syrit pa
rojën q'ishte kapardisur
— një xhandar fashist të krisur —
edhe muret si kalâ
me frangjira të puthisur! ...

U trondit i gjori djalë,
kur ky roja i tha: «Ndal!»
Vrik tetar' i rojës doli,
ashpër foshnjës na i foli:
— Ç'farë do, morë mistrec? —

Çunit fjala zu' t'i ngecë
e nga frika qante, qante
edhe pakon fort e mbante,
e shtërgonte mu në gji:
(ca duhan e një kuti,
lotët çurk e si hinxhi)
qen' dhurat' e par' e tij
për të jatin në qeli!

— Fol shpejt! Pse qan? Hë... dë, ç'do?
Ç'ke në duar, ç'jan' këto? ...

— Shok' i babit bleu pe mua
ca lotume, un c'i dua,
coja babit, ele tuaj
se të tjela do t'i luaj!

— E ç'po thua, mòr mistrec,
baba s'ësht' këtu, po ec!
Do të shtyp makina, ik,
prapsu tutje, s'paske frikë?!

Roja portën shpejt e hapi,
del makina me shpejtsi,
vogëlushi pakon kapi
që t'ia hidhte babës-zi,
se i ngjau si i jati
një, që kryet pak e zgjati,
e iu duk sikur i queshte
dhe me sytë diç i theshte! . . .

Shkon makina me shpejtsi,
bredh ky djali me habi
dhe xhandari u gajas,
kur e pa voglushin pas!

Ngrihet pluhuri si mjegull,
djal' i gjorë nuk po sheh,
këmb' e vogël has një tjegull
e rrëzohet keq përdhe. . .

I shket pakua dhe i hapet,
me turì e bryl ka rënë,
as nuk di se ku do të kapet,
nuk ka pran' as bab' as nënë!
Qan e qan, pastaj bërtet,
kur sheh gjakun të pikojë,
shtije sytë si shigjetë:
pakon, pakon të kërkojë . . .

Kur e pa të hallakatur
dhe llokumet të spërkatur,
dhëmbjet, gjakun i haroi
dhe një «oh» në çast gufmoi,
pa iu duk sikur dëgjoi
zën' e ëmbël, zëthn' e mitë:
— Mos u vrave, bir o bir?!

NËNË DHE BIR

Te shqiponj' e arratisur
u nis Cufi gënë-grisur,
hodhi supit një dyfek,
me një torb' e dy fishekë;
gjeti shokët partizanë
me qefinin në një sqetull,
gjeti trimat që nişhan
din' e marrin dhe në vetull!

Dheun kishin për dyshek,
krahun për jastëk e shtronin,
shkrepnin pushkën shtek më shtek
se armikun po sulmonin . . .
Po qëllonin mbi armikun
që mburohesh me çelnikun,
mbi tradhtarın nëpër bredha,
lapurak e zemërlik, që i bënte plumbit dredha!

Edhe Cufi, trim mbi trima,
me fishekët në gjerdani
shkrepente tok me partizanë.
Flak' e pushkës: shkrepëtimë,
kokr' e plumbit: vetëtimë,
gryk' e pushkve: batarë
mbi armiqte ra rrufë!

II

Cuf sokoli, trim me fletë,
fshinte plagët që kish marrë
her' me gjethe, her' me bar
dhe vërsulesh si shigjetë
Po ja, plumbi këtë herë

afér zemrës e kish zënë,
vdekjen pran' e kishte ndjerë,
prandaj shokut i kish thënë:

— Kur fitorja të buçasë,
vallja, kënga të kërcasë,
të këndoni përmbi varr
se fort malli do më marrë!
Këngën dua ta dëgjoj,
brenda varrit të gjëmojë
dhe do shihni një çudi
po s'u duka përsëri! —

Këto tha dhe u mendua,
pa u mvrejt, diç iu kujtua:
Te kasollja nën' e mjerë,
zemër-vrer e derë-sterë,
kur një natë në një ferrë
kishte gjetur burrë-zinë,
cop' e çikë, grir' e prerë! . . .
Sjell në mëndje ulurimën,
flokët çkulur, ngashërimën,
shtatë vjetët vrer e zi,
Po tani? . . . Oh, kush e di
ç'do të bëj' ajo mavrì! . . .

— O Tomor, o shok-vëlla,
për nënoçen kam diçka,
vet' asaj ti do t'i thuash:
«Djalin tënd, moj, po ta duash,
mos fshih helmin në krahror,
zëji vëndin në tabor!»
Kështu thuaj, o vëlla,
se mos bën ndonjë hata,
se mos qan-o më vajtim,

siç vajtoi babën tim,
se mos pret ndonjë qefin,
një qefin të lar' e shplarë,
po me lott e syve-tharë,
se në zjarr të zemrës saj
do ta ndër' e do ta thajë,
se me fije t'flokut saj
do ta qepë dhe me vrer
ma qëndis, pa ma stolis
dhe me gjak të faqes-çjerr,
pa ma çon këtu pastaj
me pshertim' të zemrës saj!...»
Amanet Tomor-vëllaj,
mos e lër të mbajë zi
pushkën time jepja ti!... —

Këto tha dhe u lëshua,
pshteti kryet mbi një gur,
shoku pranë iu betua,
e mbuloi me flamurt... .

III

N'atë fshat, që qe zhuritur,
rrinte nëna qyqe-korbë,
nën' e djegur e uritür,
në kasolle me një torbë.
Atje kishte për t'i pritur
djalin, shokët partizanë,
se atje e kish nishanë
të burr-ziut, që e preu
jatagani i një beu!

Pranë pishës, e tulitur,
syrin-çark e ballin-ngritur
rrinte nëna e drobitur

Shihte flak' e shihte tym,
jashtë ishte xëc e brymë,
shihte tymin dhe kujtonte
jetën pel e mel që hq.
shihte flakën e shpresonte
për atë q'u doq u poq,
se po priste, si çdo nënë,
një premtim, që i pat dhënë
bir' i vetëm, shpirt e xhan,
kur që nisur partizan!

IV

Shumë netë nëna kish
që po merrte një sy gjumë,
po ç'kish sonde syrin-pishë
që mendonte kaqë shumë?

— Mjera unë, nëna tha,
ç'ka kjo lemza që s'm'u nda? —
Çpaska syri, që m'u drodh,
gjoksi, që si lëmsh m'u mblohd?
Më kujton, si duket, djali
më çon lajm andej nga mali!... —

Nëna fjalën shpejt e preu
se ca këmbë sikur ndjeu,
vrik u ngrit e spatën mori,
jasht' përgjoi në rrëpirë.
— Hallë Zeno, jam Tomori! —
dolli zëri n'errësirë.

Ish Tomori, shok i djalit,
shok i loiës, shok i malit;
qe shegerthi i mullirit
që të zezen e ullirit
kishte hequr mot pas moti
nga qahjai, nga i zotil

«Kêtej punavkur t'ju bjerell
në rrezik e kurdoherët
mos më lini pa më parëim
se fort malli do më marrë!»
U tha Halla kur u nisen,
kur në mal u arratisën.
Po Tomori këtë herë
Haliën fort e përqafoi,
rrinte heshtur, pik' e vrer,
thell nga zemra ngashëroi...

Për të keqen zemra - i hante
ndaj Tomorit syt' s'ia ndante,
kur dy lot' e një rrënkim
iu këputën përbimi zjarr,
foli nëna me ngulçim:
— Ç'ke, o bir, ç'të paska ngjarë? —
Po në fyt Tomorit trim
iu lidh fjala dhe me zor
hapi gojën me drithim:
— Hallë, Cufi... ra dëshmor!

I ra gurit, e dërmoi
i ra drurit, e coptoi
i ra hekurit, e çajti
i ra nënës por e mbajti!
— Djal' i saj s'e desh oji-në
si dikur për babë-zinë,
s'e desh nënën me shami
sy-mavì e buz-mavri!
Edhe nëna derdhì lot,
po me kûje nuk e qau

se kish zemrën me barot.
Në kasollen rrëzë-shkëmbi,
ku armiku çkuli, shëmbi,
ndënji prapë duke pritur
trimat tanë partizanë
se atje mandatën mori
për të birin nga Tomori.

Nga kasollja nuk qe çkulur,
po në zemër kishte ngulur:
Një flamur me gjak stolisur,
për armiqtë kish ormisur
ca fishekë dhe një thikë,
atje nëna ngriti pritë
dhe qëllonte nat' e ditë...

U hap fjala sì veriu
mal më mal në partizanë
mbi armiqtë Halla shtiu
për të birin, për vatanë!

Vet' armiku i tèrbuar,
kur një dit' e kish rrëthuar,
i habitur kishte mbetur
dhe vetveten kishte pyetur;
kur atë e kishte gjetur
jo të gjallë po të vrarë
me shtat' plagë që kish marrë:
— C'paska patur shtatë zemra,
lindka trimi dhe te femra! —

Buzë lumi mbi bregore
ndrit lavdija mbi dy vorre;
Nën' e bir të përqafuar
me flamur të dy mbuluar.

Atje gjaku i dëshmorit
paska shkruat sipër vorrit:
«S'kemi vdekur, kemi llerë,
jemi pranë kurdoherë!»

DUKE ÇFLETUAR EPOPENË...
(Mendime dhe kujtime)

O Skënderbe, ti, o trim mbi trima;
ti, shqip' e malit; ti, vetëtima,
pallaska, thika dhe jatagane,
lavdin' dhe zemrën porsi xhephane
u le stërnipve; u le kushtrimin
edhe rrufenë tok me gjëminin,
ndaj u vërsulën porsi petrita
në gërxhe, çuka, përherë në prita:
Armiqë vranë dhe vetë ranë
për nder e vatër jetën e dhanë...
E zì po mbante gjith' Shqipërija,
u dynd me shekuj kjo robërija!...

«Për Mëmëdhenë, për Mëmëdhenë»
këndonin çetat mbi shkëmb e gur
dhe për lirinë, për Skënderbenë
betohesh trimi përmbi Flamûr!...
Po rridhte gjaku. . , Ja, Shqipërija,
porse në krye erdh' tiranija,
u dergj ky vëndi nga varfërija!...

II

Ndërsehen mbretër dhe perandorë
se mbret-tirani po bën krushqì,
ai padronët ka për dasmorë,
një dasm' e madhe me plot dollë:
Martohet shqipja me ujkn' e zi...

Kur dasma vlonte, shqiponja fshihesh
te zemra jonë, te vegjëlija,
porse dollija përherë ngrihesh;
U bë kjo dasma, u lidh krushqija,
u nis dhe paja, po jo stolija,,
se shqipja jonë në male shkoi,
atje e lirë folen ndërtoi! . . .

Prap' ndeshen mbretër dhe perandorë,
siç u ndërsyen dikur sulltanët,
padron' përlëshen me plot puntorë
dhe vranë, prenë për një kurorë...
por ja një ditë, si ajo ditë
kur hiç qe mbreti në Shqipëri,
aher kuq ujku na desh krushqì
me shqipen, pajën e me stolitë,
këputi qafën ky mbret - tirani,
po tokat shkelet nga italiani... . . .

— Shpëtuam? — pyet kjo skllavërija! . . .
— U shporr ky mbreti! — gufmon urija...
— Po Shqipërija e po lirija? —
mendojnë trimat dhe vegjëlija.

U shporr dhe mbreti, po erdhë tjetri,
i riu qenka si qe i vjetri,
u prek flamuri, u ngreh një lak,
u shkel atdheu, po jo pa gjak,
se ja, në çastin kur prekesh çaku,
me shok dha jetën Muj' Ulqinaku! . . .

Përditë psonim lloj-lloj mynxyra,
zemra po nxihesh, rrudhesh fytyra,
si fleta - u xvarrëm nëpër stuhi,

nëpër dy zgavra me rrath të zi
përherë sytë i zgurdullonim,
armiq urrenim, tradhtar' mallkonim,
po zemra jonë me afshe plot
për gjith' armiqtë u bë barot!

Sadoqë hoqëm, çfardo që pamë,
ne s'u përkulëm, as nuk u dhamë,
porse me luftë armikut lik,
që ishte mbrojtur me top çelnik
t'ia cqyënëm mishin, t'ia bënim copë
dhe trashtin, kockat e trupit tij
t'i bënim thika dhe çika-çika
t'ia grrinim mishin gjyle për top!...

Urrejtja jonë dhe cdo mallkim
iu bën' armikut një shkrepëtimë
se po na vlonët në gjë shkëndija,
na ndritte rrugën gjithmon Partija.

Dhe ja, shkëndija filloj pak
të hidhte rrezen, të bëhej flakë
nga drit' e Yllit, që na ndriçoi,
që syt'armiqë i vëngëroi...

«O burra i bini, bëni kërdi,
përmbi fashistat bëni urgjë,
sepse kushtimi në mijra zë
dërmon armiqë dhe tradhëtarë
e far' e tyre as nuk mbin më,
se kur del zëri nga vegjëlija
ësht' e vërteta, ësht' mrekullija,
me gjak fitohet, me luft' litija!»

Këshfu kushtimin e dha Partija.

Pajzit IV

Kudo luftohej me trimëri,
porse armiku pat bër' kërdi,
Nuse të reja i la të va,
foshnjet te gjiri pa bab' i la
dhe sa paj-lëna nëpërt sunduk
kur ky i vluári më nuk u duk;
po loti thahej e bëhej plumb,
nishan' i trimit askurrë s'humb,
gjersa armiku të bëhej shkrumb!


Kaluan ditë, kaluan netë,
pa shkuan muaj dhe ikën vjetë,
porse në gërxhe, mbi shkëmb si halë,
po shkrepnin xixat nga këmba strall
e partizanit me yll në ballë...

«Hapu, moj bunacë, bëhu vetëtimë,
ja po bën kërdinë kjo shqiponj' e malit
përmbi breshkamadhët, breshkat e moçalit!»

...Po këndonin vashat, vashat partizane;
po këndonin nënët, nënët kapedane;
po këndonin trimat, trimat si xhephâne
dhe po ngrihesh zemra, ngrihesh lâ më lâ
Shqipërija qenka kalâ mbi kalâ!...

V

A mposhtet, vallë, kjo trimërija,
kur në krahorin valon lirija?...
Që nga Kremlini n'Adriyatik
buçiste toka, kudo çelpi!



Luftonin popujt kundër fashistit,
kundër tradhtarit, kundër nazistik...
Po këmishzju s'duroi dot,
u dorëzuā, sytë me lot,
te partizani, që duke qeshur
me armë e lara te brezi ngjeshur,
ia fali jetën dhe e mësoi
kundër ortakut si të luftojë!

«Vdekje fashizmit, popullit liril!»
Ky ish kushtrimi për çdo shqiptar,
edhe kur erdhi armiku - i ri,
që nga fashisti qe më barbar,
po shtohej sulmi, po flakëritë
se tiga Partija po tritej, tritej!...
Bind

Gjëmonte qjelli si në furtunë,
porse nazistar të tjerë zunë,
zun' pleq e plaka edhe fëmí,
mbi ta u sulën, oho ç'batërdi,
pa vrapi, e prenë si të tërbuar,
fitoren deshën, të dëshpëruat;
pa mbollën kujë edhe rrëmëtë
kudo në fshatra dhe në qytete,
ta cduknin deshën kudo njerinë
dhe ta varrošnin tok me lirinë!...
enë

Mbaroi vallë, kjo trimërtja,
nuk kish më trima kjo Shqipëtja,
nuk kish më Vojo, nuk kish Qemal,
nuk kishte nëna që bijt t'i falë?
S'kish më petrita, Reshit Collak,
që mbi armikun lëshutën flakë
me gjoksht hapur porsi débojë,
që presin plumbë në dor' e gojë?...
enë

Po, po, ka trima kjo Shqipërija,
me gjak fitohet, me gjak lirija
dhe vdekja jote me plumb e thikë
është jetë jonë, barbati armik!
Se ja, shqiponja mbani krakët ngjitur
te kjo Partija, që ishte ndritur,
aher kur trëzeti ia dha Kremlini
që nga Vjosë e gjer te Drinë!

Prap' partizani me ngulm sulmon
mbi këtishmürmin, që është trim,
që shkrep e gjuan si vetëtime
dhe i marrrosur për gjak nga etja
është m'i llahtarshëm nga vetë vdekjal...
Po trim mbi trima je partizan
se pret me drapër, vret me çekan
se yllin, shqipen në zemër mban
lufton për jetën dhe për vatanl...

Kaluan ditë, kaluan netë,
më sterr të zeza, më me nefrët;
po nat' e fundit u bë gjith' zjarr,
u ça ky dheu ,u hap një varr:
U kall armiku se një Shqiponjë
e kish coptuar me sqep e thonjë,
kur Shpat' e kuqe që nga Kremlini
nazistar preu gjer te Berlini
dhe kur Partija si ylyber
nëpër shtërgatë dhe nëpër terr
te zemra jonë gjithmonë ndriti
dhe sihariqin na brohoriti:

«U imposht për jetë armiku - i zi,
liri e paqë në Shqipëri!»

Dhe ditët sterë, dhe netët tmer
më me ingulqime, dhe më me vler
për gjithë nazistat u bënë neshter!
Gjëmonte kënga, gaz, që çlirimit,
e cfrunte zemra dufnë e mallkimit:

Tiran i vjetër, tiran i ri,
armik i mürmë, armik i ži.
o nëm' e kombit, ti tradhëti,
ju shpirt-tiranësh, ju faqezni,
as toka sipër nuk po ju mbani,
se ndotni dheun ju gjak-katran
dhe nënët qumshtin ju bën' haram!

Fröhlicher *Störung* *verbunden* *mit* *Verlust* *oder* *Veränderung* *in* *den* *Bedürfnissen* *oder* *Wünschen* *der* *Person* *oder* *verbunden* *mit* *Verlust* *oder* *Veränderung* *in* *den* *Bedürfnissen* *oder* *Wünschen* *der* *Person*.

Wiederholung der Begriffe und Wörter
aus dem ersten Kapitel. Es ist zu beachten,
dass die Begriffe nicht in einem streng
logischen Sinn zu verstehen sind, sondern
im allgemeinen Sinn, wie er im ersten
Kapitel gegeben ist. Die Begriffe
sind hier als Beispiele für die Begriffe
im ersten Kapitel aufgeführt.

GAZE PAQ'TI PASKËTAJ

Vaj medet, çobanke, vaj!
Qaj, çobank' e vogël, qaj
se kasollja ty t'u doq!
sé manaria ty t'u poq!
Qaj, çobankë, që të qaj,
jeta qenka gaz e vaj!...

Moj e gjor', çobank' e gjorë,
mbete, moj me krab' në dorë:
T'iku dashi me këmborë,
vaj-medet, çobankë vaj!
Qaj, çobank' e vogël qaj
jeta qenka gaz e vaj!...

Bu-bu-bu, çobankë, bu,
bo-bo stani seç t'u doq,
pu-pu nëna seç t'u poq!
Ku je ti, çobankë, ku
mbete qyqe dhe kërcù!

II
Qesh, çobank' e vogël, qesh
trimat ty të prunë desh
dhe të ngritën një shtëpi
mbi gërmadhi e shkrumb e hì,
që na la armiku - i zi!

Qesh, çobank' e vogël, qesh
Pa hidh sytë dhe mbaj vesh;
Atje rrëzë të një shkëmbi,
ku armiku dogji, shëmbi,

s'ka kasolle, as köçekë,
po shtëpi edhe hambare,
ndihen këngët me zambare,
uturima e traktorit
dhe sokllima e fiçorit!

Qesh, çobankë, qesh mos qaj...
Ashtu, deh, se s'ka më vaj,
gaze paç ti paškëtaj!...

HYMN

I

Rrahu zemr' e vegjëlisë
nëpër shekuj për liri,
ndriti shpat' e trimërisë
mbi armiq' e robëril.
Po lavdija ish Partija
në kushtrimin çlirimtar,
kur sulmoi vegjëlija
mbi fashizmin gjakatar!

Lufta jonë për çlirim
imposhti mbret edhe padron,
Ylli Shqipen ndrin e priq,
jet' e lumiut pë buron;
Ngrihet zemra lâ më lâ
Shqipërija është kâlâ!

II

Dy herë rob i robëruar
partizani trim mbi ttjm,
yll e shkabë në krahruar
ndezi luftë e për çlirim:

Tym c flakë anembanë
se luftonte vegjëlija
e me drapër e çekan
po qëlllohej robërija.

Lufta jonë për çlirim
imposhti mbret edhe padron,
Ylli Shqipën ndrin e prin,
jet' e lumtur po buron:
Ngrihet zemra là më là
Shqipërija ësht' kalâ!

III

Ndriti Ylli i Kremlinit
shkrepit rrezen e lirisë,
hodhi dritën e çlirimt
te shqiponi' e vegjelisë.
Mbi gërmadha shkrumb e hi
sot po ngrihet jet' e re,
Republika plot lavdi:
Ësht' Partija — jemi ne!

Lufta jonë për çlirim
imposhti mbret edhe padron,
Ylli Shqipen ndrin e prin
jet' e lumtur po buron:
Ngrihet zemra là më là
Shqipërija ësht' kalâ!

Sandruvėn Šilad' o mūj
Mūjotyv̄ o mūjotyv̄
mūjotyv̄ o mūjotyv̄
mūjotyv̄ o mūjotyv̄

Mē duket, vētja si nē pranverē
plot kundērmime
pēr ty, o popull, qē je pranvera
e zemrēs sime!

El ūta! Ūta! ūta!
Māsa ūta! ūta! ūta!

III

Šilad' ūta! ūta! ūta!
Šilad' ūta! ūta! ūta!

Šilad' ūta! ūta! ūta!
Šilad' ūta! ūta! ūta!
Šilad' ūta! ūta! ūta!
Šilad' ūta! ūta! ūta!

KALOJNË VITET

Kalojnë vitet, porse **pranvera**,
çdo vit vjen prapë:
Bardhosh' e kuqe, si nuse nisur
edhe stolisur.
Oh, sa ma këndë të **yazhd'** e **kohës**,
që shkon me **vrap**,
të sjell në mëndje **pranverën** e **moshës**
që ka bitisur!

Dhe kur vjen dimri me shi, me borë
e suferinë,
më duket yetja si në **pranverë**
plot kundërmimë,
se malli, nderi për të punuar
më përtérijnë
për ty, o popull, që je **pranvera**
e zemrës sime!

TË KALOJË RRUGA E RE...

Një shkëmb qëndron vigan
dhe trimi rrinte pranë ...

Ia merr syri, ia kap dora
se në luft' ia bëri fora,
e me zemrën: dinamit
permbi shkëmbin vrlik u ngjitet,
ta dërmojë, ta sheshojë! ...

— Pse me shkëmbin mate ti,
kush ta dha këtë fuqi
që ta hedhesh në grëminë,
siç ke shëmbur robërini?

— Të kalojë rrug' e re!

— Ç'farë the, o trim, ç'më thë?

— Rruga që s'e njeh mbarimin,
në Kremlin e ka fillimin,
dhe do çahet në çdo vënd
se ka zemër, ësht' me mënd,
emrin tonë ajo mban,
është rruga që s'njeh anë,
është rruga e Partisë,
është rrug' e lumtërisë!

— Po do plakesh, orë trim,
do të dridhesh si purtekë!

— Jo, mër shok, se nuk jam tek,
jam milioni në miljona,
me brigata, bataljona
dhe ndërtonjës më të ri

— më me zjarr e vrull në gjë
do të ketë Shqipërija,
nuk shtëron laskur fuqija
që buron nga vet' Partizani
— Po ka breshët dhe tufan,
që të çkul e të përlan!

— Jo, mor shok, nuk njeh pëhgesë,
rruga jo në është rrembesë,
është er' e është murlan,
ferrat, drizat i përlan,
është djell e është qjell,
është rruga që s'ka cak
që të shpijtë anëmbanë
se ka yllin në bâjräk
se ka drapër e çekan!...

Ja ... trimi si vigati
krenar tani rri pranë
te shkëmbi aq i vogël,
që ishte bërë gogëll!

— Së paku që këtë
do të jepet Rini
dhe më pak që do të
pernë do të jepet
Rini do përgjigjet
Rini e zhvill
Përveç kësaj përshtatje
do t'i jepet Rini

RINË, O MOJ; RINË,
Ty dikur tē pash', moj, **Rinë**,
hedhur lahurinë,
në kasolle majë shkëmbi,
ku asgjë s'të trëmbil!

Frynte era suferinë,
moj, kërcurja **Rinë**,
po në gërxhe, rrëza bridhje,
dhe lëpjëta, mblidhjet!

Një kasolle, dhe një, dhi
kishje pasuri,
po xhelepi dherë, tymjaku
nuk t'u nda nga praku!

Zër' i beut sokellinte
Rina s'desh t'ia, dintë,
as ra kurrë nëpër leqe,
as tha lepe-peqe!

Un' tē pashë dhe në krua
kur po zbritje, **Rinë**,
shtrije çapin si pallua,
hedhur lahurinë.

Shtëmbën pash' në krye, **Rinë**,
ecje aq lehtë,
dhe me hënën ngjaje tinë,
hënën pesmëdhetë.

Po me hënën në tufan
ngjaje, **Rin'** o xhan,
se ku pula hante strall
roje plot me mall!

Mall për jetët, pët' njerihë,
moj e dhimbsur Rinë, se te drit' e pishës fitje,
fshehum pshëretijë!...

Ja, të qeshi zhëmr' e dlirtë,
ty moi Rinë-shpift, pos i vll aë shkren një prezë
përbimi ren' e zezë!...

U ndezhifta mët' lirinë,
moj sokolia Rinë, hoqë futk' e boshë orë mezit,
armët ngjeshe brezit ...

Pse godite robërinë, partizane-Rinë,
tv kasollën ta' përvluan, babën t'internuan! ...

Mbi gërmadha, shkrumb e hi,
Rinë lumia ti,
do ndërtohet jet' e re,
Rinë, lum si nel ...

Ja, tani të zbardh shamija
brënda në uzinë,
end pëlhirën vija-vija
nëpër vegje, Rinë!

Posi gur i çmuar ndrin
djersa që kullon,
me mëngoren shpejt e fshin,
qesh edhe sulmon ...

**Djersa, bulëza, në faqe,
prapë ndriti, Rinë,
e si ves' në manushaqë
duket kur s'e fshin.**

**Lodhjen e haroye fare,
Rinë, o moj xhan;
ule sytë si manâre,
kur «urra» të thanël.**

**Ti ke qen' mjerish' e fshatit,
Rinë, o moj Rinë,
lum kush, syrin, ta ka shtënë
ty për nusërinë!**

**Lum ti vetë ke imbi krye,
dhe në shpirt: Partinë,
me shqiponja ngjan, me yje,
Rinë, shoqja Rinël.**

lid o domalid, i dhomatës, i dë
li qënd, bni
ot o tui, i dhomatës, o
... ton je muri, bni

ajmëndë dhundë, o iku, o
Bnisi, o iku, iku
sift-sift, iku, iku, iku
! Bni, iku, iku, iku

o iku, iku, iku, iku, iku
, iku, iku, iku, iku, iku
, iku, iku, iku, iku, iku
, iku, iku, iku, iku, iku

KËNGA E PRANVERËS

Pash' një bajame kur kishte çelur
tok me një kumbull; që ndodhëj pranë,
dhe dy trumcakë të përkëdhelur
që nga foleja mbi degët ranë...

I pash' dhe malet që kishin ndruar
çukat e bardha me gjelbërimin;
pash' dhe pullumbat kur kraht' e shkruar
i ciknin lehtas përmbi burimia...

Kudo pash' lule edhe gjethishte,
fëmij që ngrenin ballona n'erë,
një këngë ndjeva nëpër punishte
dhe hymnin tonë si kurdoherë...

— Sa shpejt na èrdhi sivjet pravëra! —
Tinglloj zëri në zemrën time,
— Sa djell i èmbël, jo si pëfherë! —
I përshpëriti kjo zemra ime.

Duke sòdituk, rash në mendim,
më dukej çasti një vit gjëzimi,
po tek e shkuara më plot lengim
sa krah të plogta kish marr' mendimi:

Mendoj pranverën, vjete përpëra,
që posa nusja me lot, maras
në brigje shkelte, në fusha n'ara,
s'i queshte buza as për një ças!

E si të queshte ajo dikur,
kur s'kish pranverë në zemrën tonë?
Tanë e lumtur plot gaz e nûr
me paj' e krushqë po nusëron.

Pranverë jetës më prikën qark
ia shtoi nùrin çdo ças e orë,
se sy-shëgjetë mbi vëllëن-hartë,
te flokët e derdhur mban një kurojë.

Nuk është kûrora me fije ari,
as me rubina me gjethë mirti,
nuk ka gjerdanë margaritari,
nuk është bekuar me afshë shpirti!

Është një kurore më ibershime
që thuri dora në Kombinat,
me hâla gruri, më gjelberime
nga lëm i parë, posa dhuratë.

— Është një kurore që ndrin si dita,
s'ka rreze djelli, as rreze hëne,
po xixa yjesht që shkrep Selita
dhe është e mbrijtjë më qumësht nënët

Në vjeshtë, dimër dhe kurdoherë,
ajo me shoqet do pranverojë
për zemrën tonë gjithmonë pranverë
çdo vit, Nëndorit, do të ndriçojë

— Të mësuarin e dëgjave, që do përfundon

— Të mësuarin e dëgjave, që do përfundon
nëpër vëllëni që gjithmonë vëllëni
laojët që sëqë së përfundon

— Të mësuarin e dëgjave, që do përfundon
dëmën e vëllërit që t'i përfundon
të mësuarin e dëgjave, që do përfundon
dëmën e vëllërit që t'i përfundon

XHA TEMJA

Blegérin në mal të thatë
delja rudë, që menatë,
po këndon edhe këndezi,
kokorisin te qymesi
pulat, kiloçkat në mëhallë,
po xha Temja ka një hall:
Me përtim ai po ngrihet,
as në shtrat nuk po i rrihet,
kap hostenin, shkon të qetë,
nga marazi po pëllcet! . . .

Zbardhëlloi, po xha Temja
rri e rri duke menduar,
ndihen hapat edhe qerret,
krisi kënga e mëngjezit,
hingëllimat, hamulitjet
dhe kikiku i këndezeit,
një e qeshur dhe bërtimat
thonë: puna ka filluar!

C'ka xha Temja, a e dini?
O xha Teme, do ta them,
ju xanxarë mos e ngitni
se pastaj na bën ujem!

I këputet shpirti Temës
për hostenin e për qetë
se që sot e tutje n'arë
do të shkelë një lanet;
Është bisha e xhindosur,
që bërtet e shket nga dora
e si thotë vetë Temja
e ka emrin trakatora!

E si, vallë, do punohet,
nga t'ia nisë Temja, ë?
Qetë Zoti i bckoi,
ato sjellin mbarësi,
nga bërtima trëmben ëngjëjt
edhe fara s'ka si zë:
Babëzi do të na sjellë
trakatori ugurzi!...

Shkulet gazit fshat' i tërë,
po xha Temja myrejtur rri,
dilnin plisat sérë-sérë,
po vështronë me habi
edhe thoshte: «dale, dale
dardha bishtin e ka prapa
si në fusha dhe në male,
kur t'ia ndezi piskë vapa,
do të thahet, do vështroni,
fara juaj me lanetin,
pa do zini të më thoni:
— S'bëhet luftë me lanetin! —»

Me të sosur fjalët Temja
ia dha bisha ulurimës
e me bisht e krah e feçka
çante dhéuin, dilte plisi,
Teme-ziu uli kryet,
iu largua ushëtimës,
porse veshët cërr i bënin
kur po rrintepran' njëllisili!

Blegërin në mal të thatë
delja rudë, që menatë,
po këndon edhe këndezi,

kokorisin te qymezin q
pulat, kloçkat nē mëhallë, po xha Temja ka një hall:

Me përtim ai po ngrihet,
as i hahet as i pihet,
me njeri nuk po i trihet,
këmbët hiqte hosh e zvarë
e me bisht të syrit n'arë
po përgjon e po mendon...

Po sheh grurin se korrikut
ia hodh' shtatin si llastat,
ndritnin hâlat edhe kokrat,
vetëtinin si flori,
zjente puna edhe kënga:

Normën kush e sos më parë,
vetëni filli, i menduar
në një hije Temja rril

Nip 'i Temës, traktoristi,
hedh ca fjaleza me thumbar
tok me Rinën, me Banushën,
sheh xhaxhan që rrî habitur,
po për Temën fjalët, gazet
qenë thika, qenë plumba
dhe kanalin po vështronë
që gjith' arat kish vaditur!

Lëmi për karshi,
gruri si flori,
kënga që gjëmonte,
puna që valonte
(sepse lëm' i parë
shtetit si përherë,
gaz i till s'ish parë
kurrë ndonjë herë)

vérshéllimat pranë, që nuk përfundo
fyelli mënjanë, këtij vjeti, që iku
më tutje zhambaret, nisell, nd. et
këtej kanakaret
trimat që këndohin, te mbroq e M
zoqt' që ciceronin,
Temen e shastišen, te shum frum
mëndjen ia vdhisen!.

Ashtu si një plak
priti gjer në darkë, nesiq duda e
priti sa tësiknënja, nesiq i llogut, q
të thëriste nipi, do tash që dëba
Traktorist Petritin kohë ja dhimur

— O Petrit, shëstai fëmijët,
p'aja se të kam një fjale,
mos i thuaj ashjeriu, që du është
nga ty fjala mos të dalë:
Ma mëson traka, traktorin
se un' vetë do punoj,
pa do shihni që të gjithë
se sa shpejt do tju kaloj!

Shëndet sëm i kallë
jedh e kurr,
nënomëjë së mësuar
os shtetë se poqë
nëq i mësuar
Shpërthiq se shëndet
mer dallë tifët e kurr
Gjyq shtetë se mësuar

DËSHMORIT PARTIZAN

E di ku e ke varrin: I
Në hijen e Flamûrit;
ta shoh edhe lavdinë:
Në gurin e qëvurit,
çdo plag' që të dha plumbi,
pa derdhur pikë lot,
ta ndroj' në mijra lule
pranver' e jetës sot!

Çdo çast ndjej zemrën tënde:
Në mijra zemra rreh
kur shëmbet bot' e vjetër —
dhe ngrihet jet' e re!
Dhe syt' i shoh të qeshin
tek ngrihet një oxhak,
te roja në kufinë,
ku ti ke derdhur gjak!

Po shpirti yt ku shkoi?...
Në botën për matanë
apo vërtitet qjellit?!. . .
Jo, jo, këtu ësht' pranë:
E shoh te vet' Partija,
te puna që gjëmon,
në palat e Flamûrit,
e shoh kur po valon!

GJYSHJA/TREGON

I
Na ish një herë bënjet e mësuar
me një vajz' e mjerë.

Nis e sos përralla imë
me një ngjarjei të vërtetë,
me një vajzë mbetur shkretë
pas çlirimit dhe jctime,
po që lindi prap' në jetë.

— Hë, moj gjyshe, ç'jan' këto?
Nise, deh, mds na mënol!

— Po, t'u bëfsha, do filloj,
dale pakëz të mendoj
se jam plakë dhë harroj...

Mbesa - e nipër pran' i kishte
nisi gjyshja: Seç na ishte...

Ish një vashëzo, Bardhoshe,
e paç njojur në Marinë,
qëkur ishte vogëloshe,
si një flutur në lëndinë.
Ish e urtë si mushqerë,
sytë ulur kurdoherë,
mbante linj' e xhamadan,
thurur flokët një gërshetë,
vetull-hark e sy-shëgjetë,
kanakâre shpirt e xhan.
Bab' e nënë ajo ishte,
por e varfër ajo ishte;
me thërrime kish intuar,

ndaj te beu qe pajtar:
Të kulloste bagëtinë
nëpër breshër, suferinë
dhe në dark' e lodhur shumë;
me një copë bukë thatë,
kthehej vetëm sa për gjumë
te kasoll' e saj e ngratë... .

«Ja baresh' e vogël!» thonim,
po me syt' e përgëzonim,
s'e ngalaste dot njeri,
se i mbetej hatri beut,
vetëm vogëlosh' e tij
ish e bukura e dhet!
Ajo hopa duhesh marrë,
me kajmak e mjalt jetonte,
do t'ia sillnin sa më parë
edhe zogun që flutrontel... .

Nip' i vogël me cudit
pyeti gjyshen përsëri:
— Dale, gjyshe, dale pak,
ku e zinin, në folë?!

— Jo, të keqen, ja... me lak
sic bën ti nëpër bahçë!

II

...Dit' e verës kishte mbritur,
që menatë ishin ngritur
gjith' të vegjlit në Marinë,
se do venin në lëndinë
të kërcenin, të veronin
e pastaj ata do shkonin
te çdo derë të këndoanin:

«Peksimè, moj peksimè,
as na nxirt njé kokter, vè,
ashtu dalçi mot me ne
mot e; mot me ne gëzuar,
plot me djemé tè martuar!
E sa lule ka kjo thanë
aqë djem' e aq' stopanë,
e sa lule kjo qershi
e sa lesh ka mbi trë desh
aq' hambar' me grur tè ri...»

Dit' e verës kishte mbrritur
dhe Bardhoshja ishtë ngritur
e me dhën' e dhì përpara
kapérxeu fusha, ara,
mezi sosi te korrija
të kulloste bagëtija.

Po Bardhoshja ditn' e verës
e kujtoi, s'e harrtoi,
atje pranë degës ferrës
ajo zuri tè këndoje:
«Dallandyshe faqe-kuqe,
sqep-gjëlpërë, bisht-gërshtë,
na këtë gajtan tè kuq
edhe shpjere shpejt në det,
bjemë bukë dhe shëndet!»

Pastaj hoqi shpejt nga gusha
një verore përt'ia hedhur
e kur pa përtëj nga fusha
dallandyshen duke drëdhur,
u gëzua, ia vëryiti
e me këng' e brohoriti!..

III

Dallandyshja si çdo vjet
i pat prurë plot shëndet,
porse bukë aasnje herë
nuk i solli Bardhës mjerë...

Er' e qumshit e kish rritur,
Er' e malit e kish skuqur,
nën' e saj e pat selitur
e me lulet ishte puqur.
Nëpër stane, në vërrì,
nëpër diell, nëpër shì,
në burime, nëpër kroje
si manare, posa dhì
ish Bardhoshja, si ta doje!
Kur e ngitnin djemt' e fshatit:
«Moj Bardhoshe, moj majhoshe!»
as i thoshte gjë të jatit,
po me plisa i qëllonte
e si dhì përmes u shkonte.

Ish e butë si manare,
kur i vinte Lushi pranë,
as që kishte frikë fare
nga gjëmimi në tufan,
fët e fët kopën e mblidhnin,
që të dy një gunë hidhnin
nëpër gërxhe, gëufa rrinë...

Lushi ishte shok i parë,
qe i varfér dhe ay,
qenë njojur që të dy
qëkur Ionin në mullar
syllambyllazi çdo ditë;

e pastaj kur dejet, dhiçë
tok filluan t'i kullošin,
prap' e mbajtëna shqërinë
edhe bashkë të dy lošnin
në korrije, në lëndinë!

Qeshte Bardha tok me Lushin,
porse nuk n'qeshçe jetë,
për të vegjlit, pët' çdokushin
ish e hidhur e vërtetal.
Kapërxenin vreshta, ara
edhe pemët kokra plot,
porse nuk guxonin dët
as t'i shihni, drejt përpara,
se qahjaj i kishte zënë,
i pat rrahur, i pat sharë,
kur nga sheshi kishin marrë
dy qershi që kishin rënë!

I tha nipçja me inat:
— E kush ishte ky surrat?

— Trim' i beut qe qahjaj,
ish i poshtër, zemërlik,
posi beu, qerrataj,
rrithe njerzit me kamzhik! —

IV

Kur tufan' i luftës ra
përmbi kulla dhe kalâ
për lirinë, Shqipërinë,
qeshi Bardha, Lushi qeshi,
qeshi gjithë Shqipërija!
Partizani armët ngjeshi
të fitonte vegjëlia ...

Lushi. Bardha tē dy tok
nat' e ditē kok' mē kokë
kur me diell, kur me yje,
nē korrije dhe nē pyje,
kishin punë me ca trima . . .

Në Marin' u bë kërdija
fshat' i tërë shkrumb e varf
se luftonte vegjëlija
me armiq' e tradhëtarë.

Kur tufan' i luftës madhe
theu, prishi, asgjësoi,
një luan e një zorkadhe
në Marinëz i shpëtoi,
si shpëton një lule sheshi
dhe fidani pranë saj,
kur pa pritur ky rrebeshi
thyen, shëmb dhe një lisnajë! . . .

V

Kur erdh' dita e lirisë,
dit' e bardh' e vegjëlisë,
gjashtmëdhetë ishte Lushi,
pesmëdhetat Bardha mbushi.

«Eja, Bardhë!» Lushi tha,
«eja shkojmë nē qytet,
s'kemi nënë, as baba,
një kësmct i ri na pret!»

«Jo, këtu do rri», kish thënë
kjo Bardhoshja, «me xhaxhan
se Pushteti më ka dhënë
tokë, dele dhe një stan!»

«Por un'skam as kushëti,
ndaj më çojnë në Tiranë

tē mēsoj pēri bujqēsi,
nē Kēshill kēshtu mē thanē»,
iu pērgjegj Bardhoshes Lushin
edhe sytē shpejt i mbushi,

«Udh' e mbarē dhe me mēnd,
fshatin tēnd mos' e harto,
tē punosh' kētu' nē yēnd,
ku yt atē ra hero!»
i tha Bardha syt' me lot
se nuk kish duruar dot!

— Kur, moj gjishe, ra hero,
pse s'm'i thua dhe kēto,
pse tē kthehei prap' nē fshat? —
Gjyshen nipçja pyeti prapé.

... Ra hero, po vrau shtatē,
kur i vunē fshatit zjarr,
iu doq nēna dhe iu poq
nga armiq' e tradħetarē! ...

Bardhēs nēna iu kūjtua,
kur nga shkēmbi iu rēzua,
copē-ċikē iu thērmua
nē pērrua tatēpjete,
tek po mbolidhe ca lēpjete.
Pa kujtoi dhe babān
kur kish qenē partizan,
kur dha jetēn pēr lirinē,
pēr atdheun, pēr fēminē! ...

Nipçja nuk duroi dot,
si tē tjerēt derdhi lot,
mblodhi veten, u bē trim,
pyeti prap' mie ngashērim:

— E pastaj, ç'u bë, fol, hëel!

— Hiç, t'u bëfsha, s'u bë gjë,
kaq ësht' pralla, nuk ka më!

— Ç'i tha Lushi dhe ç'u bë?
... E po mbeçë më shëndetli
i kish thën' me ngashërim.

«Faqe-bardhë dhe me jetë!»
i tha Bardha më ngulçim.

Dorën dhanë dhe u ndanë;
Lushi shkoi në Tiranë,
dhe Bardhoshja për në stanë

— Aman, gjishe, fol aman,
erdhi Lushi prap' në fshat? ...

— Hajt tanë, shpejtë në shtrat,
herë tjetër do tregoj
një përrallë si do ti:
Partizanët si dragoj
kur luftoni për lirinë

BALJA

I

Halli Balen ç'e ka zënë,
e do fort fitoren:
Në vrapim e disk Vitoren
pas ka përtat lënë . . .

Tallen shoqet, Vitua qëshi,
Balja tepër mburresh,
por ajo përherë turresh
çdo mëngjëz te shëshi.

Xhamadafin; linjën çvishte
prapa gardhit n'arë,
shpejt killotët; bluzën vishte
gati si në garë.

Nëpër sheshe, brigje brichtë,
gjer te stani shkontë
dhe të nesmen diskun hidhë,
Vitox t'ia kalonte . . .

II

Djersa ndrintë si rübinë
çast për çast e orë,
po nga disku dhe vrapimi
nuk po hiqte dorë.

Balen dëndur e gjurmonin
shok e shoqe plot,
nga një herë e ngacmonin:
«Viton s'e ha dot!»

Porsc Balja as përgjigjej
tundte kryet, qeshte,
veçse zemra po i digjej:
të fitonte deshte!

III

Ja, një ditë vrapin^{te} la
në shtëpi kur shkontë,
se mësuesin ajo pa
nxënsit tek mësonte . . .

E pa erën si taçante,
hapin si ta hidhte,
pa krahrofⁱⁿ si ta mbante,
frymë si të mirrte.

Pa dhe diskun^{ti} si ta kapte,
qysh ta rrotullonte
edhe dörën si ta hapte,
kur ta flakéronte . . .

Iu bë zemra mal^e qeshi
se dikça mësoi
edhe brodhi gjen të sheshi,
fshehur ta provojë . . .

IV

Ja, një natë n'ëndër pa
veten në Tiranë,
në stadjum: burra, gra,
ardhur nga çdo anë.

E pa veten veshur-ngjeshur
ashtu si atlete
edhe njerzit buzëqeshur
i kish bë'r përvete!

U çudit se po e shihnin
gati për në garë,
sikur vetëm atë njihnin,
ngutnin për ta parë,

Sepse shoqet pas i la, po e duártrokitnin:
«Bravo ,Bale,, jepi ungah!», gjithë i bërtitain.

Ndjente xheç tē. re: nē jetē,
ëndra e gëzoi: «Po sikur tē dal vërtetë?»
Balja zu' mendoi.

Ajo prapë. kishte shpresë se mësues' i fshatit: «Balja duhet të marrë' pjesë» i kish thën' të jatit.

Po dhe shoqet këtë herë
vunë bast e thanë:
«Balja do të dalë më ndër
qoft' dhe në Tiranë!»

BALJA NË TIRANË

I

Ja dhe Balja në Tiranë
erdhi më në fund!
«Faqe-bardhë dalç!» i thanë
shoqet në katund.

Balen malli e kish marrë
se kur ish pionere
gjith' Tiranën s'e kish parë,
ndënji pak ahore.

Në stadjum nuk kishte shkuar,
garë s'kishte parë,
një gëzim e kish pushtuar
ta shoh sa më parë.

Nga një her' e zinte frika
garën kur kujtonte:
«Në s'fitofsha, mua: pikal»
veten e mallkonte.

II

Me të mbrritur në Tiranë,
në stadjum vrapoi,
hodhi sytë anembanë,
pistën e vështroi... VI

Asaj syri nuk iu trëmb,
vëndi ishte shtruar,
se mbi plisa, gur e gjëmb
ajo kish vrapuar.

Bënte prçyat çdo mëngjes,
veshur si atlete,
shoqet, që do merrnin pjesë,
i kish bër' për vete:

Me-atë shtat pos i selvi,
vrapin si shigjeta,
faqe-sheg' e sy-ulli,
flokët: dy gërshta!

III

Erdhi dita për në garë,
garë kampionati,
Balen erdhën për ta parë
shoqe, shok' nga fshati.

Bales nuri i kish rënë,
ngjante pos i nuse,
kur në mes e kishin shtënë
shoqet konkurese.

Syt' i ndritnin nga gjëzimi
pistën kur vështronte,
dit' e garës, dit' festimi,
gazin po ia shtonte.

Për fitoren s'hapi gojë,

porse kishin thënë:

«Balja, Balja do fitojë!»

bast na kishin vënërry.

IV

Në stadjum nuk kishten vend
ku të hidhje mollën,
brohoritje kënd më kënd:
Konkuruset dollën...

Nisen garat e vrapimit,
Balja pas i la,
ia kish nisur fluturimit
sikur kishte krah.

«Jepi, Balek thirrën n'emér
tutje, tej nga fundi,
Bales po i jepnin zemér
shoqet nga katundi!

Dy kurora prej dafine
përmbi krye ndritën
e me këng' e brohorime
Balen duártrokiten:

Vënd' e parë për dy herë
mori në vräpim,
një rekord e kishte thyer
ishte plot gëzim!

Shoqet, shokët kur e panë
ishin zemér-thyer
se mos Balja në Tiranë
rrinte përngahërë!

Porse Balja nuk u deh
nga fitor' e shumë,
tok me shoqet do të ngrehë
skuadrën në katund!

Qendhi, të përmposhtë
në qendhi, më shumë
ndave dhënësive nga vrashe,
mbec' i shkretë!

Ti pamposh si teknikë
si stori më poshtë
qëndë burrat përfshin
në këtë vëzhgim

KËNGA E KURBETIT

Dasm' e madhe me dolli,
me gërnet e def,
se na erdh' një kurbetlli,
far' e fis në qejf...

Ndon' i Ngjelës kish arritur,
burr' i Jasemisë,
se çdo vit e kishin pritur
shtyllën e shtëpisë!

Kishin shkuar shumë vjetë,
i kish tretur malli,
Jasemija qyqe-shkretë
qar' e kish së gjalli!

Plot dy dit' e plot dy netë
kënga tundi fshatin,
Jasemisë, Ndonit yetë
u rrëngjedhte shtatin...
II

Shihe Ndonin, Jaseminë
që punojnë n'arë,
gjithë fshati oshëtin,
këngës ia kan' marrë...

Jasemija sot gëzon
nusërin' e saj,
nga gëzimi fluturon
pas kaq vjetësh vaj.

Ja, ashtu si me tē qeshur —
Ndonin e godiste,
me tē qeshur me tē ngjeshur
po e qesëndiste.

Po kur vanë tē pushonin
tutje nëpër hije,
asaj dreka tok me Ndonin
sa i kishte shije!

Për tē shkuárën e pér sot
shumë kish f'i thonte,
ajo zemrën e kish plot
Ndonin ta qortonte.

Po më par' se ta qortojë,
këngës vet' ia mori,
loti faqeve kalloi,
hidhesh krahëtori:

«Qeraxhi, tē plastë kali
ty, o qeraxhi,
ndave nën' e bab' nga djali,
mbeç' i shkretë ti!

Qeraxhi, t'u shtershin puset,
ty, o qeraxhi,
ndave burrat, ndave nuset,
mbeç' i shkretë ti!

Qeraxhi, tē plastë mushka,
ty, o qeraxhi,
ndave dhëndërin nga krushka,
mbeç' i shkretë ti!

Ti pampor-o si çakalli,
ti sterë mos pafshë,
qamë burrat pér së gjalli,
n'ujë ti u çafshë! ...»

— Të kujtohet, hej o burrë,
dita kur u nise?
Ajo dit' mos ardhtë kurrë,
larg ti m'u dekdise!

Sa her' bâri përtërihesh,
dilja në lëndinë,
qeraxhiu vëtëm shihesh,
kurbetlinjt s'po vinë!...

Mbushe vitin dy dhe tre,
kartat m'i rrallove,
prita, prita nus' e re,
oh, sa shpejt harove!

Vjehra ime, nëna jote,
me gajrët më mbante,
hapja krahët nëpër mote,
zemra po më qante...

III

Jasemija qan nga gazi
se ka Ndonin pranë,
mjafq qe tretur nga marazi,
shoqet kur i thanë:

«Moj, ky Ndoni n'Amerikë
qenkerka martuar,
nuse-zogëzë dhe prikë
paska trashëguar!»

Porse Jasemë e shkretë
llafet s'i besoi
as kur Ndoni vitn' e tretë
kartat i rralloi.

U mbush viti, dy dhe katër
plot njëzetetëre,
qyqe-korbë n'ar e vatër
priste nus' e re!

Nus' e re pò thinjur pak,,
hedhur lahurinë,
lahurin' e zez-duvak,
zì për nusërinë!

Nusëri e vashëri
që e lan' e vanë,
po për foshnjën në pëqì
«Mashallah» i thanë,

Jasemija në shtëpi,
Jasemija n'arë,
u përvesh për angari
kock' e lëkur-tharë.

Për një krodhë bukë thatë
nëpër dyer shkonte,
herë dado, her' argat
djalin e mëkonte.

Djalin-o, nishan i burrit,
syt' e ballit-nur,
kur për 'të i binte mürit
sa her' ish sëmur!

Dhimitraqi u bë burrë
si llastar i gjatë,
mbante hekur, mbante gur,
ngrihesh që menatë ...

Ja kështu mes kasavetesh
Dhimitraqin rriti
dhe me burrin përtëj detesh
nusërin' e nxijti!

Dolli djali partizan,
pas ajo i shkoi,
se e kishte shpirt e xhan,
tok me 'të luftoi . . .

Por kur pa tê lir' atdhen;
iu çduk dhe marazi,
pa dhe birin kapiten,
s'mbahej dot nga gazit.

Shqipëri e têrë qeshi,
qeshi Jasemija,
po dhe Ndonin pran' e deshi,
kish lezet shtëpija.

IV
Atje tej n'Ametikë
Ndoni kartën moti,
në çdo fjalë loti-pikë,
hidhej krahëtori!

Malli, flaka e buxhakut
zemrën ia zhurriti
dhe pér gurët e sokakut
Ndoni psherëtiti.

Rrinte Ndoni pikëlluar
dhe në sillol,
se në zemër koh' e shkuat
i la vrag të zi.

«Kthehu Ndoni sa më patë,
Jasemija shkroi,
pér ty malli na ka marrë,
koh' e zezë shkoi.

Kthehu Ndoni, Shqipërija
s'është si më parë,
puna zjen e qesh lirija,
jeta nisi mbarë.

Kthehu Ndoni në atdhe,
kam dyzet vreten,
kam shtëpi, kam lop' e qe,
djalin: kapiten.

Kthehu Ndoni se ke punë
në vatanin tënd,
Nderi yt është këtunë,
jo në tjetër vënd!

Në je gjall' e nuk na do,
në s'u kthefshë vetë,
dit' të bardhë mos kërko,
mbeç si korb i shkretël...

Këtë kartë po ta shkroj,
un' me dorën time,
Dhimitraqi më mësoi
shkrim edhe këndime!»

V
Atje tej në Amerikë,
Ndoni kartën mori,
në çdo fjalë loti-pikë,
hidhej krahërori... IV

Soll' në mënd kasollen-kashtë,
nënën pik' e vrer
dhe qahjan që priste jashëtë
me kamzhik për sher!

Pa kujtoi Jaseminë
nusezë të re
kur u nda, oh, në lëndinë,
lotët si rrëkë!...

Push në faqe kish ay,
ajo kuq si shegë,
kur u ndanë që të dy
ngjanin lul' e degë.

Iu kujtua ajo natë,
dhëndër kur u bë,
ish e vëtmja nat' e gjatë,
s'do ta shihte më!

Sihariqin e kujtoi:
Jaseminë-nënë,
kur për djal' ajo i shkroi
posi yll e hënë.

Ndonin lemza e kujtonte,
ndizesh në krahor,
për atë dikush mendonte,
në çdo çast e orë.

Uli syt' e duke qarë
Ndoni shpejt vendosi:
Me vaporin më të parë
në atdhe të sosil...

VI

Dasm' e madhe me dollë,
me gërnet e def
se na erdh' një kurbetlli,
far' e fis në qejf...

— Pse mendohe, ç'flet me vete,
pse po psherëtin,
mos çapkënia në kurbete
nëpër sy të ndrin? —

Qeshi Ndoni dhe turflloji,
fije bâri mblođhi,
Jaseminë e qëlloi,
nëpër flok ia hodhi,

Qeshi Ndoni u gajas
tok me Jaseminë,
shqerrat blegrënин pas
losnin në lëndinë.

Ndonit zemra ju bë mal
fshatin, ku qe rritur,
nuk e gjeti si më parë,
ishte përtëritur.

Ndoni zemra ju bë mal
se pa të vërtetën,
Jasemisë ju përfal
se po ndjente jetën.

E pa punën dhe lirinë
në atdhen e vetë
e po truān, psherëtin
q'ikën ato vjetë!

«Vaj-medet o jet' e shkuar
në kurbet të zi,
qe plot vatra i ke shuar
qofsh' mallkuar ti! ..»

Nisi Ndoni të mallkojë
dhe menduar rri,
Jasemisë f'i tregojë
për kurbetn' e zi:

— Un' kujtova q'Amerika
ishte: ha merr, ik,
por un' s'mora, vetëm ika,
si s'më ra një pikë!

Si s'më mori vdekja mua,
mua dërezinë,
kur më derdhesh djersa krua
brenda në uzinë!

Në uzin' të mister Tetit,
ku më vjet' punova
dhe florinjt' si rër' e detit
un' ia grumbullova.

Unë me të tjerë tok
që u shkrimë fare,
Teti fryhesh, ne po trok
ne «heronj» për pare!

Lash një bëj e mister poqa,
më marifetçi,
një samar të vjetër hoqa,
vura një të ri!

Punë-punë, duk' nuk kish,
bobo si jetova,
djersa dilte mbi këmishë,
asgjë nuk fitova.

Shkallët zbrita, shkallët hipat
katërmëdhet' orë,
dradhja vida, ndreqja rripa,
mbeta gdhë e hot!

E kur mbeç me gisht te goja
se më la shëndeti,
vetëm karta t'ju dërgoja?
S'ish kështu kurbeti!

Vërtet' Nasi, dhe Kozmaj
çuan ca dollarë, —
por unbënë posi djaj
tretur edhe tharë!

Edhe Loni coi shumë,
hante bukë thatë,
flinte vetëm pes' or' gjumë,
mëndjen te patatë.

Për shëndetin s'kishte frikë,
mbushi xhepat plot,
po la kockat n'Amerikë,
coi ar më lot!

Ja kështu, moj, e pësova
hallemadhi unë,
për kafshat' të gojës shkova,
mbeta dhe pa punë!

Po shyqyr, moj, kartës sate
që më zgjoj nga gjumi,
në kurbet më taksiratë
do më mirrte lumi!

Ti më shkrove gjier, —
më the të vërtetën,
veçse erdha duar-thatë,
më shpëtove jetën!

Duar-thatë erdha vëtë,
po ju gjeta plot,
siç ëndroja në kurbet,
ju kam gjetur sot.

Shkoi kot kjo djersë, —
si jetim un'! mbeta,
lumturin' e plot gjëzime
un' këtu i gjeta.

Dhimitraqi, dora jötc,
mijra vet' të tjerë,
çfar' nuk ndrronin qindra mote
bëtë me një herë.

Mbollët eshtra, derdhët gjakun
kundër robërisë,
përgjithmon e muarët hakun,
hakn'e vegjelisë! —

Këto tha e mbushi sytë
plot me lote i gazi,
po një lëmsh i mbetënë fyt,
një ngulçim marazi.

Ish maraz' i kohës shkuar,
kohës tiranisë,
kur atë e pat qëlluar
plumb' i varfërisë.

Fshiu sytë edhe qeshi
Ndoni i gëzuar
se në jetë gjeti ç'deshi,
ç'kishte ëndëruar!

Brrofi shpejt në këmb' e pa
grumbuj me puntorë,
iu bë zemra mal e tha:
— Shpejtë në traktor!

Shihe Ndronin, Jaseminë
që punojnë n'arë,
gjithë fshati oshëtin,
këngës ia kan' marrë!

NJË LETËR...

Një letër dua të shkruaj unë
për në perndim,
në vend të fletës t'i mblidhja zemrat
e gjith' njerzisë
edhe për pendë të kishja rrezet
në kuqërim,
se fjalët mua m'i dhanë trimat
e gjithësisë!

Dhe letrën time do ta përcillnin
miljona zemra,
pastaj në gushën e një pëllumbi
si një gjajtan
ne do ta varnim, q'ai ta conte
përtej në vende,
ku fjala jonë do bëhet hymni
mbi çdo tiran!